



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore
Me datë 26.04.2022

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Halit Fetahu	Mës.Histori	Roli i motivimit në të nxënit e lëndës së historisë sipas perceptimit të nxënësve dhe mësimdhënësve të shkollave të mesme të ulëta	Kryetar/e	Ethem Ceku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Demë Hoti
2	Fisnik Morina	Mës.Histori	Zhvillimi i të menduarit kritik të nxënësve përmes kërkimit të informacionit në lëndën e edukatës qytetare	Kryetar/e	Nysret Pllana
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Demë Hoti
3	Fitim Thaci	Mës. Gjeografi	Zbatimi i vlerësimit përmbledhës një dhe dy nga mësimdhënësit e gjeografisë dhe ndikimi i tyre në arritjet e nxënësve	Kryetar/e	Arsim Ejupi
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
4	Xhyfidane Zejnullahu	Mës. Gjeografi	Mësimi me projekte në funksion të arritjes së kompetencës “nxënës i suksesshëm”	Kryetar/e	Florim Isufi
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Ethem Ceku
5	Albert Rashiti	Mës. Fizikë	Përpunimi i njësisë mësimore për energjinë në mësimin e integruar të shkencave natyrore në SHML	Kryetar/e	Arlinda Damoni
				Mentor/e	Zeqir Shaqiri
				Anetar/e	Jehona Ferizi
6	Armend Dodaj	Mës. Fizikë	Të nxënit e koncepteve termodinamike me anë të demonstrimeve në shkollat e mesme të ulëta	Kryetar/e	Eda Vula
				Mentor/e	Zeqir Shaqiri
				Anetar/e	Vlora Sylaj
7	Anduena Hykolli	Mës. Biologji	Qëndrimet e nxënësve të klasës së tetë për mjedisin dhe kulturën mjedisore	Kryetar/e	Ruzhdi Kuqi
				Mentor/e	Zeqir Veselaj
				Anetar/e	Sylejman Berisha
8	Ermonda Foniqi	Mës. GJLSH	Përdorimi i prozës në tekstet shkollore të gjuhës shqipe	Kryetar/e	Naser Pajaziti
				Mentor/e	Atdhe Hykolli
				Anetar/e	Minevere Rashiti
9	Donjeta Doroci	Mës. GJLSH	Fragmentet e shkëputura nga romanet e ndryshme në tekstet shkollore të shkallës së katërt	Kryetar/e	Myrvete Dreshaj
				Mentor/e	Atdhe Hykolli
				Anetar/e	Minevere Rashiti
10	Anita Haziri	Mës. GJLSH	Ndikimi i llojeve të letërsisë gojore nga tekstet shkollore të shkallës së katërt në të nxënit e nxënësve për kulturën popullore	Kryetar/e	Atdhe Hykolli
				Mentor/e	Myrvete Dreshaj
				Anetar/e	Ganimete Kulinxa
11	Zana Saramati	Mës. Kimi	Efekti i aplikimit të strategjive në të nxënit e kimisë inorganike në shkollën e mesme të ulët	Kryetar/e	Ruzhdi Kuqi
				Mentor/e	Islam Krasniqi
				Anetar/e	Teuta Danuza

Kandidati/ja: 1. Halit Fetahu

Tema: Roli i motivimit në të nxënit e lëndës së historisë sipas perceptimit të nxënësve dhe mësimdhënësve të shkollave të mesme të ulëta.

ABSTRAKTI

Një nga sfidat e vazhdueshme që hasim ne si mësimdhënës në orët mësimore, pa dyshim është edhe se sa dimë t'i motivojmë nxënësit gjatë të nxënit në procesin mësimor, andaj në këtë punim synohet që të tregohet puna e mësuesit, metodat, teknikat dhe strategjitë që i vë në përdorim gjatë orës mësimore, për t'i nxitur dhe motivuar nxënësit për të qenë sa më aktivë në procesin mësimor.

Motivimi përfaqësohet nga forcat që veprojnë mbi ose brenda një personi dhe e detyrojnë atë që të sillet në një mënyrë të caktuar, sepse jo të gjithë nxënësit janë të njëjtë dhe nuk mund të motivohen nga e njëjta gjë. Andaj detyrë e çdo arsimtari mbetet të dijë si t'i motivojë nxënësit në mënyrë sa më efektive. Çdo aktivitet mësimor për të qenë i suksesshëm është ngushtë i lidhur me motivimin, andaj motivimi është ai i cili të gjallëron. Përmes një pyetësoi do të analizojmë njohuritë dhe praktikat që kanë dhe përdorin mësimdhënësit për t'i motivuar nxënësit në lëndën e historisë dhe do të përpiqemi të kuptojmë se cilat janë strategjitë që ndikojnë në motivimin efektiv të nxënësve.

Mbledhja e informacioneve do të realizohet nëpër shkolla të mesme të ulëta me nxënës të klasave të gjashta, shtata, tetave dhe të nënta, me ç' rast në pyetësor do të përfshihen edhe mësimdhënësit e lëndës së historisë.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të tregojnë qasjen dhe njohuritë që përdorin mësimdhënësit për t'i motivuar nxënësit dhe do të vihen në pah vështirësitë me të cilat ata ballafaqohen.

Fjalët kyçe: Angazhimi, dënimi, historia, mësuesi, metoda, motivimi, nxënësit, notimi, shpërblimi.

Kandidati/ja: 2. Fisnik Morina

Tema: Zhvillimi i të menduarit kritik të nxënësve përmes kërkimit të informacionit në lëndën e edukatës qytetare

ABSTRAKTI

Aktualisht, një nga çështjet domethënëse të arsimit është zhvillimi i të menduarit kritik tek nxënësit. Aftësia për të menduar në mënyrë kritike bëhet një nga çështjet kryesore në sistemin e arsimit profesional dhe lejon nxënësit të lundrojnë shpejt dhe saktë në fushat e tyre, për t'u përshtatur në mënyrë fleksibile në botën e biznesit dhe shkencës dhe sistemin e ri të arsimit dhe menaxhimit. Për shkak të këtij sistemi të arsimit, paraqitet nevoja e krijimit të kushteve për zhvillimin e mendimit kritik si një nga përbërësit më domethënës në zhvillimin e aftësive të tyre. Me anë të këtij hulumtimi paraqesim rëndësinë e informacioneve në zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve në lëndën e edukatës qytetare si dhe rëndësinë e zhvillimit të të menduarit kritik në rritjen e aftësive vlerësuese. Ky hulumtim u realizua përmes metodës kualitative.

Hulumtimi u realizua në disa shkolla fillore. Mostra ishte e qëllimshme dhe pjesëmarrja ishte rreth 200 nxënës.

Rezultatet e dala nga ky hulumtim do të sensibilizojnë në radhë të parë nxënësit, por edhe mësimdhënësit si dhe nxënësit e Fakultetit të Edukimit lidhur me rolin që luan marrja e informacioneve në zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve në lëndën e edukatës qytetare.

Fjalët kyçe: informacion, burim, mendimi kritik, metodat e mësimdhënies, mësimdhënësit, shkolla.

Kandidati/ja: 3. Fitim Thaci

Tema: Zbatimi i vlerësimit përmbledhës një dhe dy nga mësimdhënësit e gjeografisë dhe ndikimi i tyre në arritjet e nxënësve

ABSTRAKTI

Për një proces të suksesshëm dhe ngritjen e cilësisë në të nxënë, vlerësimi konsiderohet ndër shtyllat kryesore të punës në arsim. Në kurrikulën shkollore të Kosovës është planifikuar edhe vlerësimi përmbledhës vp1 dhe vp2, përmes të cilit vërehet mënyra e të nxënit, angazhimit dhe përparimit të nxënësve si dhe sigurohet kthimi i informacioneve nga ana e mësimdhënësve për vështirësi ose përmirësime. Metodot e vlerësimit kanë qenë dhe ende janë burim i rëndësishëm për të parë se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe çfarë ata duhet të mësojnë më mirë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është zbatimi i vlerësimit përmbledhës vp1 dhe vp2 në mënyrë sistematike nga ana e mësimdhënësve të gjeografisë dhe arritjet e nxënësve, duke bërë analizimin e instrumenteve të formatit të cilin e aplikojnë tani mësimdhënësit sipas kornizës kurrikulare. Për të parë se cili është formati i hartimit të një note përfundimtare në lëndën e gjeografisë do të realizojmë këtë hulumtim në shkollat e mesme të ulëta në komunën e Hanit të Elezit.

Pyetje kryesore e këtij hulumtimi është: Sa zbatohen vlerësimi përmbledhës vp1 dhe vp2 nga ana e mësimdhënësve të gjeografisë dhe cili është ndikimi i tyre në arritjet e nxënësve? Pjesëmarrës në këtë hulumtim do të jenë: dy drejtorë, dy kordinatorë të cilësisë, dhjetë mësimdhënës të lëndës gjeografi, dhe tridhjetë nxënës nga shkollat e mesme të ulëta.

Metodologjia që do të përdoret gjatë këtij hulumtimi do të jetë hulumtimi në veprim, ndërsa metoda është e përzier, sasore dhe cilësore. Për mbledhjen e të dhënave do të shfrytëzohen disa teknika si: pyetësi për drejtorë, kordinator cilësie, mësimdhënës, nxënës, vëzhgimi i ditarëve personal dhe fizikë, punëtorja me mësimdhënës, intervista finale.

Mësimdhënësve kurrikula u jep të drejtën që të gjejnë mënyrën më të mirë të mundshme që ata të frymëzojnë nxënësit e tyre me një kënaqësi dhe angazhim për të mësuar.

Fjalët kyçe: Vlerësim përmbledhës, Arritja e nxënësve, Zbatimi, Kurrikula, Mësimdhënësit.

Kandidati/ja: 4. Xhyfidane Fejzullahu

Tema: Mësimi me projekte në funksion të arritjes së kompetencës “nxënës i suksesshëm”

ABSTRAKTI

Kurrikula që promovon dhe mbështet zhvillimin e kompetencave i ndihmon nxënësit, të eksplorojnë dhe kuptojnë botën rreth tyre, të ndërlihdhin përvojat e tyre të të nxënimit me jetën e vërtetë dhe zhvillojnë kompetenca në nivel të lartë dhe në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre. Arritja e kompetencave synohet të bëhet kryesisht me metoda bashkëkohore të mësimdhënies, prandaj në këtë studimin do përdorim metodën mësimi me projekte në funksion të arritjes së kompetencës “nxënës i suksesshëm” në lëndën e gjeografisë. Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënimit, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm.

Por, sa janë arritur me sukses kompetencat e Kurrikulës , më konkretisht kompetenca e 3-të dhe sa ndikon mësimi me projekte në zotërimin e kësaj kompetence nga ana e nxënësve përgjigjet i gjejmë nga rezultatet e paraqitura nga informatat e siguruar në teren. Ky punim është bazuar në metodologjinë ku është përdorur kryesisht metoda kualitative e mbledhjes së të dhënave, dizajni i hulumtimit ka qenë ai përshkrues dhe mostra kampioni i qëllimshëm, ku popullacionin e kanë përbërë nxënësit e Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta dhe mësimdhënësit e lëndës së gjeografisë po në këto shkolla. Në fund janë paraqitur rezultatet e që janë bërë në stilin narrativ.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të arrijmë një përfundim nëse puna me projekte në lëndën e gjeografisë kontribuon në zotërimin e kompetencës “nxënës i suksesshëm”, arritje e cila kërkon angazhimin e gjithë stafit të shkollës.

Fjalët kyçe : Kompetenca, Gjeografia, Korniza Kurrikulare, Kurrikula Bërthamë, Mësimi me Projekte

Kandidati/ja: 5. Albert Rashiti

Tema: Përpunimi i njësisë mësimore për energjinë në mësimin e integruar të shkencave natyrore në SHML

ABSTRAKTI

Mësimi i energjisë është një nga temat më të rëndësishme në mësimdhënien e shkencave natyrore. Të kuptuarit e energjisë në shkencat natyrore dhe trajtimi i problemeve praktike që dalin gjatë këtij procesi janë objekt studimi në këtë punim. Ne paraqesim një qasje ndërdisiplinore të bazuar në kërkim për mësimin e energjisë, duke marrë parasysh ligjet e termodinamikës që interpretojnë proceset fizike, kimike e biologjike. Për këtë punim janë hulumtuar materiale të shumta në gjuhën amtare dhe në gjuhë të huaja duke u analizuar metoda e hipoteza të ndryshme, duke u nisur nga ato klasike, deri tek ato bashkëkohore, ku përmes tyre jemi munduar t'i paraqesim sa më në detaje të gjitha të gjeturat. Gjithashtu kemi hulumtuar edhe në praktikë në dy shkolla të mesme në Shtime, duke vëzhguar orë mësimore, duke mbajtur pyetësorë me nxënës dhe intervista me mësimdhënës. Punimi fokusohet tek ngritja e hipotezave mbi problematikat e mësimin të energjisë në shkencat natyrore nga nxënësit e shkollave të mesme. Analiza e rezultateve të hulumtimit tregon një kuptim më të mirë të konceptit të energjisë nga ana e nxënësve.

Fjalët kyçe: energjia, shkencat natyrore, mësimdhënie, nxënës, fizika, termodinamika

Kandidati/ja: 6. Armend Dodaj

Tema: Të nxënit e koncepteve termodinamike me anë të demonstrimeve në shkollat e mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Hulumtimi “ Të nxënit e koncepteve termodinamike me anë të demonstrimeve”, ka për qëllim të kuptoj rolin dhe efikasitetin e të nxënit të koncepteve termodinamike në fizikë, sa demonstrohet lënda e fizikës në të kuptuarit e koncepteve termodinamike, si dhe cilat janë përceptimet e nxënësve lidhur me demonstrimet. Në interes të këtij hulumtimi janë edhe përceptimet e mësimit lidhur me demonstrimet, sa i praktikojnë dhe cilat janë kushtet që ofrojnë shkollat për demonstrim të lëndës. Po ashtu, është analizuar se cila është mënyra më efektive për përfundimin e një demonstrimi: nga mësuesi apo nga vet nxënësi.

Për mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim është përdorur metoda e përzier (sasiore dhe cilësore). Mostra e këtij hulumtimi përbëhet nga gjithësej 122 respondent, prej tyre 50 nxënës të klasave të nënta nga ShFMU “Emin Duraku” Gjakovë, 50 nxënës nga ShFMU “Yll Morina” Gjakovë, 16 nxënës nga ShFMU “Fan S. Noli” dhe nga 2 mësues për secilën shkollë. Për të kuptuar përceptimet e nxënësve dhe mësimit lidhur me demonstrimin dhe se sa përdoren ato në shkollat e tyre, respondentët në fjalë i janë përgjigjur një pyetësori me pyetje të mbyllura dhe për mësues pyetje të hapura dhe të mbyllura. Duke u bazuar në qëllimin e hulumtimit, është ngritur një pyetje kryesore e hulumtimit si dhe dy nënpyetje në lidhje me atë se: cili është niveli i demonstrimit në shkollat tona, cilat janë përshtypjet e nxënësve dhe mësimit për rëndësinë e demonstrimit në fizikë.

Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se të nxënit e koncepteve termodinamike arrihen shumë më lehtë dhe në mënyrë efektive kur nxënësit mësojnë përmes demonstrimit, sesa nga forma tradicionale e ligjerimit. Gjatë demonstrimit nxënësit rrisin interesimin dhe kureshtjen dhe shfaqin kreativitetin e tyre në forma të ndryshme. Në këtë hulumtim shohim që nxënësi e kupton shumë më mirë fenomenin kur ai vetë realizon demonstrimin, sesa kur demonstrohet nga mësuesi. Në përgjithësi, nga mostra e hulumtimit, mund të konkludojmë se shkollat e kumunës së Gjakovës janë relativisht mirë të pajisura me mjete didaktike, kabinete dhe laboratore, si dhe ka një nivel të kënaqshëm të përdorimit të demonstrimeve në klasë.

Fjalët kyçe : demonstrimi, eksperiment, mësuesi, mësues

Kandidati/ja: 7. Anduena Hykolli

Tema: Qëndrimet e nxënësve të klasës së tetë për mjedisin dhe kulturën mjedisore

ABSTRAKTI

Gjendja e mjedisit asnjëherë nuk ka qenë prioritet për vendin tonë. Zbatimi i dobët i ligjeve të mbrojtjes së mjedisit dhe mungesa e kontrollit, çdo ditë e me shumë po sjellë ndotje të vazhdueshme të ujit, ajrit e tokës. Hedhja e mbeturinave në mjedis mbetet si një nga problemet më serioze të dukshme. Për të kuptuar më shumë rolin e qëndrimet e nxënësve për mjedisin është realizuar ky hulumtim i cili do të mbështetet në të dhëna sasiore, për të analizuar më afër sjelljen dhe qëndrimin e nxënësve shkollën fillore "Dardania" të Prishtinës. Target grupi ishin nxënësit e klasës tetë. Në këtë hulumtim janë intervistuar 20 nxënës nga gjitha klasët, dhe pyetësi me 120 responent varësisht nga numri i nxënësve në klasë. Përzgjedhja ishte bërë në mënyrë rastësore. Gjatë realizimit të këtij hulumtimi me anën e metodës sasiore do të mbledhim të dhëna numerike, për t'i analizuar dhe përdorur si sondazhe për qëndrimet e nxënësve të klasëve të teta për kulturën mjedisore. Ku si instrument për mbledhjen e të dhënave primare dhe sekondare do të merren intervistat dhe pyetësorët. Kurse me metodën cilësore të dhënat interpretohen dhe strukturohen nga hulumtuesi si pjesë e punës analitike.

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se aspekt shumë dominant ishte se nxënësit për ndotjen e ajrit i kanë të niveleve të larta të njohurive dhe kjo për shkakun se ndoshta shkolla është në territori urban (qytet), por edhe ndoshta për shkak të përdorimit të internetit si në procesin mësimor ashtu edhe në jetën private.

Nga hulumtimi me nxënës vërehet dukshëm se ka një kuptueshmëri të detajuar të koncepteve mjedisore dhe jovetëm por edhe të formimit të sjelljes miqësore ndaj mjedisit. Aspekt shumë me rëndësi në formimin e sjelljeve pro-mjedisore është edhe fakti se nxënësit kanë njohuri rreth pasijeve shtëpiake me kursin të energjisë ose eko, si dhe ndikimin e tyre në shpenzim të ulët të energjisë si masë për mbrojtjen e mjedisit. Aspekt shumë me rëndësi dhe që u vu re ishte edhe fakti se nxënësit u shprehën të pakënaqur në lidhje me faktin se çka ofrohet në shkollë nga përmbajtjet mësimore në lëndët për mjedisin jetësor. Vlenë të theksohet fakti se ata nuk janë të kënaqur sidomos me aktivitetet e pakta me karakter mjedisor që ofrohen në shkollë.

Fjalët kyçe: edukim mjedisor, kulturë mjedisore, nxënës, qëndrime.

Kandidati/ja: 8. Ermonda Foniqi

Tema: Përdorimi i prozës në tekstet shkollore të gjuhës shqipe

ABSTRAKTI

Në këtë punim synojmë që përmes hulumtimeve të vëmë në dukje përdorimin e prozës në tekste, duke u fokusuar sidomos në librat shkollorë të gjuhës shqipe. Sikurse edhe gjuhët e tjera, shqipja ka në tipin e prozës, llojet kryesore që janë: fabula, anekdota, tregimi, përralla, novela dhe romani. Në tekstet shkollore të gjuhës shqipe nga klasa e gjashtë e gjerë në klasën e dymbëdhjetë, shohim që kemi përdorim të prozës në tekste shkollore, ku rëndësi të veçantë u japin edhe autorëve që kanë shkruar një lloj të caktuar të prozës. Këtu duhet veçuar sidomos gojëdhënat e shkruara, tregimet, pjesë të romaneve, etj., të cilat i japin ngjyrim teksteve shkollore. Në këtë hulumtim kemi vëzhguar se cilat prej llojeve të prozës përdoren më shumë në këto tekste shkollore, çfarë pjesë fragmentesh të shkëputura të romaneve përdoren dhe si janë zhvilluar ato më tej te nxënësi. Do të dimë më shumë se cilat lloje të prozës kanë zënë vend në këto tekste shkollore, cilat nuk janë zhvilluar më tej dhe cilat janë futur të reja. Rëndësia e prozës në tekstet shkollore dhe mënyra e paraqitjes e shtjellimi i saj ka një vlerë të lartë, sepse nëpërmjet saj nxënësi njihet edhe me periudhat letrare të gjuhës shqipe. Në gjuhën e prozës ndërthuren rrëfimi, monologu dhe dialogu. Aty kemi përshkrim të hollësishëm të një ngjarjeje me disa personazhe, përmes të cilëve shkrimtari rrëfen në vetën e tretë dhe në kohën e shkuar.

Fjalët kyçe: Gjuha, shkrimi, shkolla, llojet, hulumtimi, karakteristikat, nxënësi.

Kandidati/ja: 9. Donjeta Doroci

Tema: Fragmentet e shkëputura nga romanet e ndryshme në tekstet shkollore të shkallës së katërt

ABSTRAKTI

Tekstet shkollore bazë janë një ndër elementet kryesore për funksionimin e mirëfilltë të procesit të mësimdhëniës, ato luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e procesit mësimor, fal tyre nxënësit marrin njohuritë themelore që ata duhet t'i fitojnë gjatë secilës shkallë. Këto tekstet zakonisht përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe me kalimin e kohës jemi deshmitar të evolimit të këtyre teksteve, secilën herë duke u përsosur, në mënyrë që para nxënësve të paraqesim tekste sa më adekuate , nga më të duhurat.

Tekstet e reja shkollore të lëndës së gjuhës shqipe janë të paisura me të dhëna të shumta nga më të ndryshmet , të gjitha në funksion të nxënësit në mënyrë që të arrihen njohuri nga më të ndryshmet. Ato kanë për qëllimin afësimin e nxënësve në shumë aspekte të rëndësishme si: të folurit e bukur, të shkruarit e drejtë , të pasurohen me fjalë e shprehje të reja e të bukura, e kjo më së miri arrihet nga puna me tekstet e shumta, fragmentet nga veprat e ndryshme si: poezi, tregime, romane etj, të huaja dhe shqiptare. Objekt studimi i kësaj teme do të jenë: Fragmentet e shkëputura nga romanet e ndryshme në tekstet shkollore të shkallës 4, tekstet do të jenë: Leximi letrar 8 (pra për klasën e tetë) nga Mazllom Kumanova dhe Munish Hyseni, botuar nga Libri shkollor dhe leximi letrar 9 (për klasën e nëntë) nga Arif Demolli botuar nga Libri shkollor , pra në këtë temë diplome do paraqesim fragmentet e marra nga romanet e ndryshme të huaja dhe shqiptare dhe do flasim për rolin (funksionin) që këto fragmente kryejnë dhe vendin që ato zënë në këto tekste shkollore të klasës së VIII dhe të IX. Qëllimi i këtij punimi është që nëpërmjet metodave analitike, hulumtuse, komparative të paraqesim rëndësinë e këtyre fragmenteve në përfitimin e njohurive, ndërtimin e shkathtësive dhe formimin e aftësive të shumta letrare e gjuhësore që lidhen ngushtë me kulturën e shkrimit, shprehjes së mendimeve, të nxënësve të shkollës filllore më konkretisht klasës VIII dhe IX.

Fjalët kyçe: tekst shkollor, roman, fragment, nxënësi, njohuri .

Kandidati/ja: 10. Anita Haziri

Tema: Ndikimi i llojeve të letërsisë gojore nga tekstet shkollore të shkallës së katërt në të nxënit e nxënësve për kulturën popullore

ABSTRAKTI

Krijimtaria popullore që shpesh quhet edhe krijimtaria gojore, në vete përfshin përrallat, gjëegjëzat, legjendat dhe krijimet e ndryshme popullore. Quhen të tilla ngase rrëfehen me gojë dhe janë bartur brez pas brezi. Ky lloj i krijimtarisë ka lindur më herët sesa krijimtaria e shkruar, atë e ka kultivuar shtresa e gjerë popullore e pashkolluar dhe e ka bartur ndër breza. Nga kjo që u tha arrijmë të kuptojmë se, krijimtaria popullore nuk krijohet nga turma, por duke u shtrirë gjithnjë e më gjerë dhe duke pësuar ndryshime, përshtatje e modifikime, ajo humb autorësinë e saj dhe bëhet krijim popullor.

Objekt shqyrtimi i këtij punimi është pikërisht tema “Ndikimi i llojeve të letërsisë gojore nga tekstet shkollore të shkallës së katërt në të nxënit e nxënësve për kulturën popullore”. Ajo se çka do të shqyrtojmë është krijimtaria popullore, vlerat e kësaj krijimtarie dhe vendi që zë në tekstet shkollore.

Brenda punimit në mënyrë analitike do t’i qasemi literaturës bazë, teksteve shkollore. Do të hulumtojmë se çka përfshihet në këto tekste, sa ndikon në kulturën e nxënësve krijimtaria popullore. Një analizë të veçantë do t’i kushtojmë nxënësve, formimit të tyre dhe sa është e rëndësishme njohja e këtyre shkrimeve popullore për ta.

Rëndësia e njohjes së kësaj krijimtarie qëndron në atë se nxënësit e çdo niveli duhet të njohin të kaluarën e popullit të tyre, fillimin e krijimit të popullit dhe vlerat e çmuara të letërsisë sonë. Ne do të analizojmë a është e mjaftueshme sasia e këngëve, përrallave, legjendave tona të krijuara nga populli në shkolla, përkatësisht në klasat e teta dhe të nënta. Kemi hulumtuar tekstet shkollore, kemi gjetur literaturën e duhur dhe kemi filluar punën në këtë drejtim.

Si mostër do të përdorim të dhënat e nxjerra nga hulumtimi me pyetësorë në dy shkolla të qytetit të Podujevës, në shkollën “Naim Frashëri” dhe “Shaban Shala”. Pjesë e hulumtimit përmes pyetësorëve do të jenë rreth 300 nxënës të klasave të teta dhe të nënta, si dhe rreth 10 mësimitdhënës të po këtyre shkollave.

Do të përgatisim një pyetësor të veçantë për mësimitdhënësit e këtyre shkollave dhe një për nxënësit. Pyetësorët do të jenë me alternativa, nxënësit dhe mësimitdhënësit do të përgjigjen me rumbullaksime, duke zgjedhur alternativën që sipas tyre është më e përshtatshme. Do të jenë rreth 300 pyetësorë për nxënës dhe rreth 10 pyetësorë për mësimitdhënës (sipas numrit të nxënësve dhe mësimitdhënësve të dy shkollave të Podujevës). Kemi punuar me metoda cilësore dhe sasiore, jemi munduar të mbledhim sa më shumë materiale edhe me ndërthurje të metodës historike, përshkruese e krahasuese. Të gjitha të dhënat sjellin një përmbledhje të letërsisë popullore, teksteve shkollore dhe gërshetimit mes tyre.

Fjalët kyçe: Krijimtaria gojore, tekstet shkollore, nxënës, formim, kulturë popullore.

Kandidati/ja: 11. Zana Saramati

Tema: Efekti i aplikimit të strategjive në të nxënit e kimisë inorganike në shkollën e mesme të ulët

ABSTRAKTI

Viteve të fundit arsimit në Kosovë ka patur ndryshime të shpejta në drejtim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies e sidomos në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm. Këto ndryshime paraqesin sfida të reja me të cilat po ballafaqohen mësimdhënësit për t'u përshtatur me kurikulat mësimore. Në këtë rast sa i përket lëndës së kimisë në Shkollat e Mesme të Ulta, bëhet fjalë për një qasje më bashkëkohore të aplikimit të strategjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies me një përkushtim më të madh.

Në këtë hulumtim qëllimi parësor është çështja e avansimit të kualitetit të praktikës mësimore. Për këtë është e nevojshme që nga perspektiva e nxënësve të kemi një pasqyrë të strategjive mësimore të cilat aplikohen në mësim në përgjithësi e posaqërisht në mësimin e kimisë inorganike. Mostra e përzgjedhur përbëhet prej dy paraleleve të klasës së shtatë, gjegjësisht të kl. VII 1. me 25 nxënës si klasë kontrolli dhe klasa VII 2 , me 28 nxënës si klasë eksperimentale.

Për nevoja të këtij hulumtimi, janë konstruktuar: Pyetsori (A) mbi përfaqësimin e strategjive mësimore gjatë kohës së hulumtimit; Pyetsori (B) mbi përfaqësimin e motivimit në mësimin e kimisë (variabla e varur); Pyetsori (C) mbi kontributin e strategjive të mësimdhënies dhe motivimit në arritshmërinë e mësimin të kimisë. Në këtë punim është përfshirë edhe një përmbledhje e shkurtër e strategjive dhe metodave të avansuara.

Nga përpunimi i të dhënave del se arsimtarët shërbejnë me strategji të ndryshme mësimore. Kontributi i strategjive mësimore është më i dukshëm gjatë punës në laborator dhe kur nxënësit nxiten për punë të pavarur.

Fjalët kyçe: Kimia inorganike, strategjitë e mësimdhënies, efektet e strategjive.